



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 01, datë 16.03.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA**  
**TROPOJË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.2, DATË 09.12.2017**  
**TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të neneve 11 dhe 12 të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 2, datë 09.12.2017 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tropojë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tropojë, si dhe referuar Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 16, datë 28.02.2022, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Në Planin e Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë, të miratuar me Vendimin Nr.2, datë 09.12.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, të bëhen ndryshime në dokumentin e:
  - *Rregullores së Planit:*
    - Pas nenit 23 shtohet neni 23/1 me titull “*Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm*”;
    - Pas nenit 30 shtohet neni 30/1 me titull “*Rregullat për zhvillimet në sistemet urban, bujqësor dhe natyror*”;
    - Pas nenit 32 shtohet neni 32/1 me titull “*Kushte për objektet ekzistuese në sistemin bujqësor dhe natyror*”;
    - Pas pikës 7 të nenit 38 shtohen pikat 8 dhe 9;
    - Pas nenit 41 shtohet neni 41/1 me titull “*Rregullat për ndërtimet në afërsi të kanaleve ujitëse dhe të kullimit*” dhe Neni 41/2 me titull “*Linja Elektrike*”;
    - Reformulohet neni 45;
    - Pas nenit 47 shtohet neni 47/1 me titull “*Kufizimi i ndërtimeve përgjatë rrugëve të kategorive A, B dhe C*”;
    - Reformulohet neni 55;



- *Tabelat e treguesve të zhvillimit të njësive strukturore;*  
Ndryshime të “Hartës së rrjetit rrugor të propozuar sipas kategorive të Kodit Rrugor të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Tropojë”.

sipas Dokumentit të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë, bashkëlidhur këtij Vendimi.

2. Ngarkohen Bashkia Tropojë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për botimin e Vendimit dhe dokumentit shoqërues të tij, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit, si dhe për përditësimin e informacionit GIS dhe platformës e-Harta, sipas ndryshimeve të miratuara.
3. Ngarkohen Bashkia Tropojë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, si dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin e territorit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

